



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE  
KOMISIONERI SHTETËROR I ZGJEDHJEVE

Data: 28.02.2025

Nr: 220

Ora: 12:00

**VENDIM**

**PËR**

**SHQYRTIMIN ADMINISTRATIV BAZUAR NË DENONCIMIN NR. 21 ID,  
DATË 17.02.2025, TË REGJISTRIT TË DENONCIMEVE, TË KOALICIONIT  
PËR REFORMA, INTEGRIM DHE INSTITUCIONE TË  
KONSOLIDUARA/KRIIK**

Sot më datë 28.02.2025, Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve, mori në shqyrtim çështjen administrative me:

**KËRKUES:** Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara/  
KRIIK

**SUBJEKT:** **Z. Ledion Lako**  
Drejtor i Përgjithshëm, Agjencia Kombëtare e Bregdetit

**OBJEKT:** Përdorimi në postimet e aktiviteteve institucionale të Institucioneve në varësi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit, të sloganeve/hashtag-eve partiakë/elektoralë

**BAZA LIGJORE:** Neni 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f” dhe pika 2, neni 91, pika 1 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, nënpika 1.3, pika c, të nenit 3 të vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator

Në përfundim të këtij shqyrtimi,

**K O N S T A T O J :**

Koalicioni për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara (KRIIK), më datë 17.02.2025, ka paraqitur në Komisionin Qendror të Zgjedhjeve (KQZ) nëpërmjet adresës së postës elektronike e-mail, denoncimin e administruar në regjistrin e denoncimeve me nr. 21 ID.

Data:28.02.2025 Nr: 220

Ora:12:00



“Për shqyrtimin administrativ bazuar në denoncimin nr. 21 ID, datë 17.02.2025, të regjistrin të denoncimeve, të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të konsoliduara /KRIIK”

Në këtë denoncim, KRIIK parashtron sa vijon:

*“Përgjatë gjithë periudhës parazgjedhore, në faqet zyrtare në “Facebook” të disa Institucioneve të varësisë së Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit janë duke u përdorur slogane elektorale të Partisë Socialiste, në formën e hashtag-eve.*

*Këto slogane është vërejtur se i përmban Faqja Zyrtare në Facebook e Institucionit të mëposhtëm, Institucion në varësi të Ministrisë së Turizmit dhe Mjedisit:*

*- Agjencia Kombëtare e Bregdetit.”*

Me vendimin nr. 115, datë 20.02.2025, të Komisionerit Shtetëror të Zgjedhjeve (KSHZ), u vendos fillimi i procedurës administrative, për shqyrtimin e këtij denoncimi. Bazuar në këtë vendim, i'u kërkua personave përgjegjës pranë Agjencisë Kombëtare të Bregdetit (AKB) për raportimin e veprimtarive publike, që të paraqesin prapësimet në lidhje me çështjen objekt hetimi.

KQZ administroi pretendimet e personave përgjegjës për raportimin e veprimtarive publike, nga Agjencia Kombëtare e Bregdetit të dërguara me e-mail në KQZ, të cilët deklaruan si vijon: *“Ju informojmë se janë marrë menjëherë të gjitha masat e nevojshme për amendimin e postimeve nga të gjitha rrjetet sociale të institucionit. Personi i ngarkuar nga institucioni nuk ka pasur dijeni se hashtaget e kësaj forme mund t'i referohen subjekteve politike.”*

Më datë 28.02.2025, ora 12:00, u zhvillua seanca dëgjimore, ku u ftuan të gjitha palët në proces për t'u shprehur në lidhje me çështjen objekt shqyrtimi. Në tërësi palët iu qëndruan pretendimeve të paraqitura elektronikisht.

Në vlerësim të pretendimeve të palëve, fakteve dhe provave të administruara në këtë shqyrtim administrativ, çmoj se kërkimi sipas objektit i KRIIK, është i mbështetur në ligj, përkatësisht në nenin 91, pika, 1 të Kodit Zgjedhor, *“Me përjashtim të rasteve të parashikuara me ligj, nuk mund të përdoren ose të vihen në mbështetje të kandidatëve, të partive politike ose të koalicioneve në zgjedhje, burime të organeve apo enteve publike në nivel qendror ose vendor, apo çdo lloj enti tjetër ku shteti zotëron kapitale apo kuota ose/dhe emëron shumicën e organit mbikëqyrës apo organit administruar të entit, pavarësisht nga burimi i kapitalit ose pronësia”.* Po ky nen parashikon se *“burime” quhen asetet e luajtshme dhe të paluajtshme, të parashikuara në nenin 142 të Kodit Civil, si dhe çdo burim njerëzor i institucionit”.*

Vënia në dispozicion e faqeve zyrtare në “facebook” apo çdo mjeti tjetër elektronik (media sociale) të institucioneve publike për publikimin e postimeve apo të ripostimeve të cilat përmbajnë hashtag #, slogane me karakter politik/elektoral në zgjedhje, apo thirrje për mbështetje në zgjedhje nga ana e këtyre institucioneve përbën përdorim të burimeve publike.

Nga hetimi administrativ u provua se postimet, ripostimet dhe pëlqimet janë bërë në faqet zyrtare të rrjetit social “Facebook” të institucionit subjekt i këtij denoncimi.

Pas verifikimeve të kryera nga ana jonë, u konstatua se postimet, ripostimet dhe pëlqimet, me karakter politik janë fshirë nga rrjetet sociale të institucionit.

Sa më sipër, vlerësoj se duhet të pushohet hetimi, duke i'u tërhequr vëmendje Drejtuesve të Institucioneve Publike që të tregojnë kujdes të shtuar në publikimin e postimeve apo ripostimeve të ndryshme me përmbajtje politike apo elektorale, duke mos lejuar shpërndarjen dhe ripostimin e veprimtarive politike apo elektorale të Institucioneve të tyre eprore, pasi përbën shkelje të

dispozitive ligjore të Kodit Zgjedhor dhe vendimit nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, të ndryshuar.

### **PËR KËTO ARSYE:**

Bazuar në nenin 19, pika 1, shkronjat “dh”, “f ” dhe “n”, pika 2, nenin 91 të ligjit nr. 10019, datë 29.12.2008, “Kodi Zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar, vendimin nr. 9, datë 9.3.2021, dhe vendimin nr. 9, datë 24.12.2020, të Komisionit Rregullator, të ndryshuar,

### **V E N D O S:**

1. Pushimin e shqyrtimit administrativ të denoncimit nr. 21 ID, datë 17.02.2025, të Koalicionit për Reforma, Integrim dhe Institucione të Konsoliduara ndaj:
  - Z. Ledion Lako, Drejtor i Përgjithshëm i Agjencisë Kombëtare të Bregdetit.
2. Rezultatet e këtij vendimi i njoftohen palëve nëpërmjet adresës së postës elektronike.
3. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe publikohet në faqen zyrtare të internetit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Komisionin e Ankimeve dhe Sanksioneve brenda 3 (tre) ditëve nga shpallja e tij.

**Komisioneri Shtetëror i Zgjedhjeve**

**Illirjan CELIBASHI**

